



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 13

Datë: 23. 04. 2023. Ora: 18:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Fillimisht, kryetari Radoniqi, pasi përshëndeti anëtarët dhe pjesëmarrësit, paraqiti rendin e ditës lidhur me këtë mbledhje. Pas votimit të rendit të ditës, u shqyrtua pika e vetme e rendit të mbledhjes.

2. Shqyrtimi dhe miratimi rekomandimit për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV), për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut që do të mbahen më datë 23 prill 2023,

Kryeshefi **Burim Ahmetaj**, tha se duke u mbështetur në procesin zgjedhor, KQZ duhet të marrë një vendim për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV), për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të komunave në Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave në Zveçan dhe Leposaviq, dhe me qëllim të zbatimit të vendimit të KQZ-së.

Ai, e njofti KQZ-në se Sekretariati i ka marrë të gjitha veprimet për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV). Nga Mitrovica e Veriut, janë 69 anëtar të KVV që

duhet të paguhen, në Zveçan 22 anëtarë të KVV-së, në Zubin Potok 9 anëtarë të KVV, dhe Leposaviq 37 anëtar KVV. Pra, janë gjithsej 137 anëtar të KVV dhe staf teknik.

Ahmetaj, tha po ashtu se në komunat Zveçan dhe Zubin Potok, në disa vendvotime, anëtar të KVV janë të angazhuar Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve, dhe se pagesa e tyre do të bëhet njëjtë sikur stafi i SKQZ përmes punës jashtë orarit.

Për realizimin e votimit të kategorisë së personave me nevoja të veçanta përkatësisht kategorisë së të ngjuarve nëpër institucione, do të angazhohen ekipet mobile me nga tre (3) anëtar që kryesoheshin nga Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve.

Në fund, z. Ahmetaj, tha se do të bëhen edhe pagesat e stafit jo permanent, si dhe pagesat e faturave të kontratave të furnizimeve dhe të shërbimit të zgjedhjeve për Kryetar të komunave në Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave në Zveçan dhe Leposaviq.

Anëtarët e KQZ-së, pas shqyrtimit dhe analizave lidhur me këto zgjedhje, e miratuan këtë rekomandim të Sekretariatit.

3. Të ndryshme